



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 57 prot.

Himarë, më 30.10. 2023

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.10.2023, ora 10 :30, në sallën e Këshillit Bashkiak Himarë mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës për muajin tetor, të Këshillit Bashkik Himarë.

1. Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët:

Gjergji Iliadhi, Elisabeta Lamaj, Dhimitër Kapaj, Loreta Isufi, Thodhori Foto, Nertila Husi, Mirka Gjiçali, Milto Nika, Aleks Llazari, Fuat Mati, Timoleo Gërdhuqi, Qirjako Mërkuri, Lenica Kocani, Miltiadh Prifti, Maks Vlasi, Artan Bala, Thëllëza Kokaveshi, Afrovita Dhimojani.

2. Mungojnë: Silva Burbo, Artionil Shirokaj, Nikilin Laska.

Në mbledhje marrin pjesë: Drejtoritë, kryetari aktual i Bashkisë Z. Gjergji Goro.

3. Sigurohet pjesëmarrja e këshilltarëve mbi 50%.

Komunikohet këshilltarëve shprehja e ligjshmërisë nga prefektura për muajin shtator.

Mbledhjen e hap kryetari i këshillit Z. Dhimitër Kapaj.

***1. Pika e parë e rendit të ditës.**

Miratimi i rendit të ditës.

- Përshëndetje! Jeni dakort me rendin e ditës?
- Dakort- këshilltarët.

2. Pika 2

Shqyrtimi i projektvendimit për përcaktimin e numrit maksimal të punonjësve të policisë bashkiake.

Afrovita Dhimojani: - është një vendim që na vjen i paplotë, mendoj që ky vendim nuk ka ligjshmërinë, ne nuk mund ta miratojmë këtë material pa ditur buxhetin, kërkojmë nga drejtoria t'na japin informacion.

Kryetari këshillit:- në fakt policia bashkiake duhet falenderuar për punën e bërë,duhet vlerësuar puna që është bërë.

Drejtori Andon Xani:- vendimin e miraton këshilli,ndërsa struktura është pjesë e bashkisë.

Afrovita Dhimojani:-Bashkia ka strukturën dhe buxhetin ,ne nuk jemi kundër por duam të dimë pjesën e buxhetit.

Drejtori Andon Xani:- keni detyrim ligjor ta miratoi këshilli numrin e policisë së bashkisë.

Timoleo Gërdhuqi:- numri maksimal i strukturës kalon në buxhet? Ky material nuk mund të vijë i ndarë nga buxheti.

Mirka Gjçali:- miratohet numri i policisë pra futet në buxhet,për mua duhet ta miratojmë.

Kryetari i këshillit lexon realacionin bashkëngjitur projektvendimit.

Thëllëza Kokaveshi :- ka një bashkërendim ku thotë,miratohet bashkë buxheti dhe struktura,kjo mund të vijë bashkëngjitur me buxhetin dhe të studiohet me materialin përkatës,nuk kundërshtojmë por duam material të plotë dhe të rishikojmë.

Drejtorja juridike :- duhet të jeni të qart ,materiali ka ardhë si iniciativë ligjore,ku vijnë ndryshimet në strukturë,është paraqitur në këtë moment sepse miratojmë numrin maksimal dhe së bashku me buxhetin do ta paraqesim.

Fuat Mati:-Për aq kohë sa në administrat futet edhe policia ne nuk kemi pse nxitojmë sepse miratojmë numrin maksimal të policisë,ta kalojmë me buxhetin.

Milto Nika:-policia bashkiake është e ndarë me kategori,projektvendimi është shumë i saktë dhe hyn në fuqi pasi miratohet buxheti,deri sa të miratohet buxheti dhe të vijë struktura do të përgatitet,punonjësit do të fillojnë punë mbas miratimit të buxhetit.

Kryetari i këshillit:- i jep fjalën kryetarit Gjergj Goro

Kryetari Bashkisë Z. Gjergj Goro:- me lejen tuaj kryetar i uroj këshillit bashkiak ,suksese! Jam në detyrë dhe do ta vazhdoj deri sa të jetë ligji,ligji na bashkon të gjithëve.Përgjegjësinë për gjithë procesin e bashkisë e ka kryetari i bashkisë,nuk ka pse ngec puna,ne kemi sjell projektvendimin për policinë bashkiake,të gjithë policët duhet të trajtohen,të rinjtë edhe pastaj të nisë puna,duhet të miratojmë numrin dhe pastaj strukturën.Me ligjin e mëparshëm është miratuar nfa ministria ,tani i është kaluar këshillit. Numri maksimal që kemi menduar është 25 edhe kaq nuk mjaftojnë.

Qirjako Mërkuri:- Më problem shoh policinë bashkiake,doja t'ju bëja një pyetje,a' jeni dakort me pagën?

Kryetari këshillit jep leje përgjegjsit e policisë.

Meçan Myrtaj:-rritja e pagës është bërë edhe vitin e kaluar,por futet edhe vjetërsia,mendoj janë të kënaqur punonjësit.

Miltiadh Prifti:-Duhet të vinte më i detajuar si informacion ,dua një informacion nga drejtoria Bashkiake,a' është i mjaftueshëm numri i policisë?

Shpjegon drejtori:- numri i efektivëve që kemi aktualisht është i mjaftueshëm,neve duam të kalojmë numrin pastaj strukturën,i mjaftueshëm nuk është sidomos në sezonin turistik.

Lenica Kocani:-të vijë me plan dhe t'a miratojmë.

Kryetari këshillit:- e hedhim në votim?

Nuk miratohet materiali mbi numrin e policisë bashkiake.

Pika 3

Shqyrtimi i projektvendimit për miratimin e nismës,për rishikimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Himarë

Kryetarja e grupit të këshilltarëve opozitar Afrovita Dhimojani kërkon që të shtatë anëtarët e komisionit të diskutojnë veç mbi këtë projektvendim.

Dakort:- kryetari këshillit

Afrovita Dhimojani:- si komision dolëm në përfundim se kjo nismë duhet t'na vijë më e detajuar dhe e realizuar.

Nuk kemi një analizë sa leje ndërtimi janë dhënë në 6-vjeçarin e fundit.

Drejtori Genti Strakosha:- kjo nismë nuk ka lidhje me këtë analizë.

Afrovita Dhimojani:- kërkojmë planin e përgjithshëm ,sa pdf janë miratuar.

Kryetari këshillit:- nuk je dakort që të marrim një nismë në teritorin e Bashkisë Himarë?

Loreta Isufi:-Nëse keni vrejte për dokumente shtesë le t'na vijë më vonë,këtë material e kemi lexuar.

Timoleo Gërdhuqi:-nuk jemi kundra zhvillimit,por janë bërë padrejtësi në lidhje me këtë çështje

Shpjegon drejtori :-për dy vjet janë mbledh ankesat e njerëzve dhe më janë drejtuar si drejtori,janë parë si zona,por pa marr këtë nismë nuk mund të shqyrtojmë,ky dokument nuk miraton asgjë,është ministria e mjedisit,turizmit,është këshilli e të tjerë,analizën do ta keni radhës tjetër,ky material është i detajuar.

Kryetari këshillit:- kush është dakort të miratohet materiali?

Miratohet vendimi nr.48 mbi nismën e planit të përgjithshëm vendor,të Bashkisë Himarë me 10 vota pro, 8 kundër,0 abstenim

Pika 4

Informacion mbi mbylljen e sezonit turistik,viti 2023 dhe problematikat e vrenjtura.

Thëllëza Kokaveshi:-Investimet e ujit në mënyrë kategorike duhen përmirësuar,pa depozita nuk ja del mbarë turizmi.

Zhvillimi urban,autobuzat duhet të kenë stacione,pika ndalimi.

Milto Nika:-Problemet e turizmit,prespektiva e shtimit të turistëve është të rritet .

Sasia e tonëve të plehrave po rritet,firmit e pastrimit duhen të jenë më cilësore.

Të ketë stacion autobuzash.Të merren masa mbi parkimin.Në shumë vende publike na dalin pronar privat parkimi.

Lenica Kocani:- pleherat në Dhërmi nuk mund të meren derë më derë,duhet të ketë kazan për grumbullim.

Të grumbullohet uji sepse po derdhet në rrugë,kërkojmë pastrimin e varrezave,pastrimi i rrugëve brenda fshatit.

Kazanët e plehërave të çohen afër familjeve të banuara.

Fuat Mati:-Ka një problem me sinjalistikat e shpejtësisë,të çohen disa në Borsh,një te ujëvara,te parkimi,sinjalistikë ku tregon se është shkolla.

Miratohet materiali për sezonin turistik 2023,Bashkia Himarë.

Pika 5

Raporti i performancës për vitin 2022 dhe problematikat e vrenjtura.

Miratohet materiali mbi performancën.

Pika 6

Shqyrtimi i projektvendimit për ndihmën ekonomike ,periudha 1-30 shtator,fondi 6% i bllok – ndihmës ekonomike.

Miratohet vendimi nr 49 mbi ndihmën ekonomike,6% për muajin shtator 2023.

Pika 7

Shqyrtimi i projektvendimit për zgjedhjet e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave Bashkia Himarë.

Shqyrtimi i ankesave dhe procesverbalëve .

Timoleo Gërdhuqi:- në nenin 20 të rregullores duhet të ndryshohet ku thotë se kryetari fshatit nuk mund të zgjidhet më shumë se dy mandate.

Kryetari këshillit:- jo ,nuk marrim vendime tani.

Shpjegon drejtorja juridike .

Shqyrtimi i ankesës nga kryesia e fshatit Vuno.Shpjegojnë komisionerër që kanë zhvilluar zgjedhjet në këtë fshat.

Artan Bala: proceduam në bazë të ligjit,nuk pati shkelje,zgjedhjet u monitoruan me kamera.Timoleo Gërdhuqi:- lexoni procesverbalet.

Shqyrtimi i kërkesës për kryesinë e fshatit Pilur.

Komisionerër Dhimitër Kapaj dhe Timoleo Gërdhuqi:-ka qënë një proces zgjedhor shumë transparent dhe bazuar në ligj dhe rregullore.

KËRKESË KËSHILLI:drejtuar gjëndjes civile për fshatin Vuno dhe Pilur për listën e anëtarëve të zgjedhësve.

Shqyrtimi i kërkesës nga kryesia e fshatit Qazim Pali.

Shpjegojnë anëtarët e komisionit Timoleo Gërdhuqi dhe Elisabeta Lamaj. Diskutohet dhe hidhet në votim që Qazim Palit t'i njihen zgjedhjet me 9 vota pro,6 kundër,o abstenim.

Kryetari këshillit: unë për vete jam kundër.

Kërkesë e kryesisë së fshatit Dhërmi.

Diskutohet në këshill për caktimin e datës së zgjedhje brenda muajt nëntor në fshatin Dhërmi

Kryetari këshillit:- fshati duhet të jetë në unamitet për zgjedhjet që kur të shkojmë të bëjmë zgjedhjet,të caktojmë,të caktojmë dy anëtar këshilli sipas orarit nga ora 08:00 deri ora 14:00 .

Afrovita Dhimojani:- do të mblidhemi si kryesi dhe caktojmë datën .

Kryetari këshillit:-lexon projektvendimin e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave.

Miratohet vendimi nr .50 me 10 vota,6 kundër,0 abstenim

Afrovita Dhimojani:- kërkesë si grup opozitar,propozojmë betimin e kryetarit të bashkisë në format auto-vizive ose të shkojmë ku ndodhet Z.Beleri në paraburgim.

Kryetari këshillit:-Na sillë kërkesën për në mbledhjen e radhës.Pa propozimin e kryetarit të këshillit 9 këshilltar e aprovuan kërkesën për betimin e kryetarit të Bashkisë Alfred Beleri (kërkesa u dorëzua dhe u votua nga 9 këshilltar.)


Mbyll mbledhjen kryetari këshillit.

Pika të ndryshme (s'ka)

Dy kërkesa të fshatit Borsh dhe Vranisht ngelën për muajin tjetër.

Sekretari

Elena Memushaj



Kryetari

Dhimitër Kapaj

